

VENDIM
Nr.12, datë 15.3.2007

**PËR SKEMËN EKZISTUESE “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT,
NËPËRMJET FORMIMIT NË PUNË”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

Z. Genc Ruli	Kryetar
Znj. Mimoza Dhëmbi	Anëtare
Znj. Mimoza Vokshi	Anëtare
Z. Viktor Gumi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 15.3.2007 shqyrtoi raportin “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë””. Raportimi është bërë pranë Drejtorisë së Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta me shkresën nr.295, datë 12.2.2007 dhe është regjistruar në regjistrin e DNSH-së me nr.AI/006/2/2005.

Baza ligjore: Si bazë për dhënien e ndihmës është neni 6 i ligjit nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si edhe pika 1 e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë”.

Objekti/vat: Skema synon të ndihmojë punëdhënësit që angazhojnë për qëllim formimin nëpërmjet punës, të personave punëkërkuar të papunë, të cilët janë persona profesionalisht të pakualifikuar për proceset e punës.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema përmban dy elemente ndihme: ndihma për trajnim, nëpërmjet formimit në punë për ata që vetëm trajnohen dhe nuk punësohen pas mbarimit të kursit të formimit, si dhe ndihma për punësim, pasi ndërmarrja duhet të punësojë të paktën 40% të numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve në formim.

2. Intensiteti i ndihmës për pikën e parë të vendimit llogaritet të jetë 71,4%, që është më i lartë se kufijtë e përcaktuar në ligjin e ndihmës shtetërore për ndihmën për punësim dhe në rregulloren për ndihmën rajonale për nxitjen e punësimit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

3. Intensiteti total i skemës tejkalon edhe më shumë kufijtë maksimalë të lejuar në legjislacionin e ndihmës shtetërore.

4. Megjithatë udhëzimi nr.73, datë 14.1.2004 për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.73, datë 11.2.1999, synon të përcaktojë procedurat e kontrollit dhe monitorimin e rezultateve të skemës, në zbatimin praktik ka munguar kontrolli i plotë mbi skemën dhe rezultatet e pritshme të saj.

5. Në skemë nuk është përcaktuar detyrimi për kthimin e ndihmës, nëse ndërmarrjet nuk përmbushin angazhimet e tyre në kuadër të skemës.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10 shkronja “c”, paragrafi 2, dhe nenit 11 shkronja “a” të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, si dhe nenit 6 të rregullores “Për kushtet dhe procedurat e dhënies së ndihmës rajonale”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.815, datë 28.12.2005,

PROPOZON:

1. Skema të rishikohet duke ndarë në mënyrë të qartë komponentin për trajnim, nga ai për punësim.
2. Që skema të bëhet e lejueshme për pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave, duhet ose të ulët niveli i subvencionit, ose të rritet numri i punonjësve të cilët ndërmarrja është e detyruar të punësojë për të paktën një vit.
3. Pika 2 e vendimit të Këshillit të Ministrave, duhet të hiqet, pasi tejkalon kufirin maksimal të intensitetit të lejuar të ndihmës.
4. Të përcaktohet afati përfundimtar i mbarimit të skemës.
5. Të parashikohet që të gjitha ndërmarrjet që nuk plotësojnë detyrimet e tyre në kuadër të skemës, të kthejnë të gjithë ndihmën/subvencionin e marrë, së bashku me interesat.
6. Të parashikohet që autoriteti përgjegjës për zbatimin e skemës duhet të raportojë brenda datës 31 mars të çdo viti, të dhënat për zbatimin e skemës në vitin paraardhës financiar. Këto të dhëna duhet të ruhen deri në 10 vjet pasi është dhënë ndihma/subvencioni i fundit në kuadër të skemës.
7. Çdo projektakt normativ i Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, lidhur me procedurat dhe kriteret e zbatimit të skemës “Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkuesve të papunë”, duhet të marrë miratimin paraprak të KNSH-së.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Genc Ruli